



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISË  
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 83 .....Prot.

Tiranë, më 05.01 2018

**NJOFTIM**

**MBI FILLIMIN E BISEDIMEVE PËR LIDHJEN E KONTRATËS KOLEKTIVE TË  
PUNËS NË DEGËN E MËSUESISË**

Në zbatim të Kreut XV të Kodit të Punës dhe kërkesës së disa organizatave përfaqësuese sindikale, grupi i punës, i ngritur me urdhrin e MASR nr. 627, datë 11.12.2017 “Për ngritjen e grupit të punës për shqyrtimin e dokumentacionit dhe zhvillimin e bisedimeve për lidhjen e Kontratës Kolektive të punës në degën e mësuesisë”, njofton fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive të punës në degën e mësuesisë.

Të gjitha organizatat përfaqësuese sindikale në degën e mësuesisë ftohen të shprehin interesin dhe të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm brenda datës 22 janar 2018 pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Dokumentacioni duhet të përmbajë:

1. Kërkesë për fillimin e bisedimeve.
2. Vendimin e Gjykatës dhe statutin e organizatës ose organizatave.
3. Dokumentacionin me treguesit e nevojshëm për përfaqësueshmërinë e anëtarësisë sindikale.

Ky njoftim të afishohet në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe të gjitha Drejtoritë Rajonale Arsimore dhe Zyrat Arsimore.

**KOLI BELE**

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

